



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d), 34 dhe 40.2 shkronja l) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040, në pajtim me Udhëzimin Administrativ (MAPL) nr.02/2019 për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e Komunave me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane, dhe nenit 3 të Rregullores komunale nr.prot.01-016/01-0058139/22 për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Podujevës të datës 15 korrik 2022, neneve 14, 15 paragrafi 2.3 dhe nenet 29 dhe 34 paragrafi 2.12 të Statutit të Komunës së Podujevës, nr.prot.01-020/01-0050862/18, si dhe në rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa nga mbledhja e datës 21.05.2024, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 23 maj 2024, mori këtë:

V E N D I M

Neni 1

Me këtë vendim bëhet plotësim ndryshimi i Vendimit të Kuvendit nr.prot.01-020/04-0101084/22 datë 09 dhjetor 2022 për formimin e komisionit për koordinimin e procesit të zgjedhjes së këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane në territorin e Komunës së Podujevës, përkatësisht;

- **z.Shuajb Blakçori**, U.D. drejtor i Drejtorisë së Administratës në Komunën e Podujevës, emërohet anëtar në kuadër të Komisionit të cekur nga radhët e Ekzekutivit të Komunës, në vend të znj.Antoneta Ejupi, ish drejtoresh e Drejtorisë së Administratës.

Neni 2

Ky vendim është pjesë përbërëse e Vendimit të Kuvendit nr.prot.01-020/04-0101084/22 datë 09 dhjetor 2022 për formimin e komisionit për koordinimin e procesit të zgjedhjes së këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane në territorin e Komunës së Podujevës.

Neni 3

Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 dit pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren nr.06/2021.

Nr.Prot. 01-016/01-0033735/24
Podujevë, datë: 23 maj 2024



Kryesuesi i Kuvendit
Elmi Hoxha



KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d) dhe 34 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040, Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.02/2019 për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e Komunave me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane, nenit 3 të Rregullores komunale nr.prot.01-016/01-0058139/22 për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Podujevës të datës 15 korrik 2022, neneve 14, 15 paragrafi 2.3 dhe 29 të Statutit të Komunës së Podujevës, nr.prot.01-020/01-0050862/18, Kuvendi i Komunës së Podujevës, pas rishqyrtimit sipas Shkresës së Ministrisë së Pushtetit Lokal nr.020-1019/8 datë 01.12.2022 për vlerësimin e ligjshmërisë së aktit, në mbledhjen e mbajtur më 09 dhjetor 2022, mori këtë,

VENDIM

FORMIMI I KOMISIONIT PËR KOORDINIMIN E PROCESIT TË ZGJEDHJES SË KËSHILLAVE TË FSHATRAVE, VENDBANIMEVE DHE LAGJEVE URBANE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË PODUJEVËS

Neni 1

1. Për koordinimin e procesit dhe zgjedhjen e Këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane në territorin Komunës së Podujevës, formohet komisioni, në këtë përbërje:

- 1.1. **Ardi Hasani**, anëtar nga radhët e Kuvendit të Komunës-LVV
- 1.2. **Ekrem Rrahmani**, anëtare nga radhët e Kuvendit të Komunës-LDK
- 1.3. **Mimoza Abdullahu**, anëtare nga radhët e Kuvendit të Komunës-PDK
- 1.4. **Burim Hasani**, anëtar nga radhët e Kuvendit të Komunës-AAK
- 1.5. **Antoneta Ejupi**, anëtare nga radhët e Ekzekutivit të Komunës
- 1.6. **Bleona Rama**, anëtare nga radhët e Shoqërisë civile
- 1.7. Anëtar/e përfaqësues nga këshilli i fshatit, vendbanimit, lagjes urbane, i cili propozohet dhe zgjedhet me shumicë të votave nga të pranishmit në tubimin zgjedhor të Këshillit përkatës.

2. Në aspektin teknik, administrativ dhe profesional, Komisioni Bashkëpunon me nëpunësin civil – Koordinatorin për bashkëpunim me këshillat lokale.

3. Kryesuesi i Komisionit, rregullat dhe mbarëvajtja e punëve dhe takimeve caktohen në takimin e parë të Komisionit, i cili ftohet nga Kryesuesi i Kuvendit.

Neni 2

Komisioni sipas nenit 1 të këtij vendimi, vepron konform Rregullores nr.prot.01-016/01-0058139/22 për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Podujevës, si dhe dispozitave ligjore dhe nënligjore përkatëse në fuqi, si dhe i njëjti obligohet t'i raportoj Kuvendit të Komunës rreth rrjedhës së tubimeve, zgjedhjes së Këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, si dhe çështje tjera relevante që ndërlidhen me këtë proces, pasi të ketë përfunduar i tërë aktiviteti si dhe pas çdo aktiviteti eventual që mund të paraqitet brenda mandatit.

Neni 3

Komisioni formohet në kohëzgjatje të njëjtë me mandatin e Kuvendit të Komunës, brenda të cilit i njëjti mund të plotësohet dhe ndryshohet me vendim të Kuvendit.

Neni 4

Për zbatimin e vendimit kujdeset Kryetari i Komunës, Kryesuesi i Kuvendit dhe Drejtoria e Administratës.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, ndërsa anulohet vendimi nr.prot.01-020/04-0093836/22 i miratuar nga Kuvendi i Komunës më datë 07 nëntor 2022.

Nr.prot. 01-020/04-0101084/22
Podujevë, datë; 09 dhjetor 2022

